



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 1285/5 prot

Datë 10.07.2023

V E N D I M
Nr. 583/2023

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Fiorent Zguro	Nënkryetar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 10.07.2023 me:

Objekt: Vendim për mbylljen e çështjes mbi ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur – “Marrëveshje Kuadër – me disa operatorë ekonomikë – me afat 24 muaj” me Nr. REF-58631-02-10-2023, me objekt: Loti 1, “*Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues*” me fond limit **7,107,802** (shtatë milion e njëqind e shtatë mijë e tetëqind e dy) lekë (pa TVSH) **61,206** (gjashtëdhjetë e në mijë e dyqind e gjashtë) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 10.02.2023 është 116.13 lekë), parashikuar për tu zhvilluar në datën 15.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

Autoriteti Kontraktor: Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara
Adresa: Blv. “Dëshmorët e Kombit”, Nd. 1, 1001, Tiranë.

Ankimues: Operatori Ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK.
Adresa: Fshati Ahmetaq, pranë firmës Ital Kon

Baza Ligjore: Nenet 30, 115, 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, i ndryshuar Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksonimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, i Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të

Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlera limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Operatori ekonomik ankimues ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 13.02.2023, është publikuar në Sistemin e Prokurimeve Elektronike procedura e prokurimit “Procedurë e Hapur – “Marrëveshje Kuadër – me disa operatorë ekonomikë – me afat 24 muaj” me Nr. REF-58631-02-10-2023, me objekt: Loti 1, “*Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues*” me fond limit **7,107,802** (shtatë milion e njëqind e shtatë mijë e tetëqind e dy) lekë (pa TVSH) **61,206** (gjashtëdhjetë e në mijë e dyqind e gjashtë) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 10.02.2023 është 116.13 lekë), parashikuar për tu zhvilluar në datën 15.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara.

II.2. Në datën 17.05.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave nga ku rezulton për vlerat pa TVSH si më poshtë:

1.	“EURO MEGA 2010” SHPK	3,616,700 lekë	skualifikuar
2.	“ANBIM” SHPK	3,685,045 lekë	skualifikuar
3.	“I&V COMPANY” SHPK	4,697,500 lekë	kualifikuar
4.	“SOLID GROUP” SHPK	4,753,800 lekë	skualifikuar

5.	“EGIAN MED” SHPK	5,200,000 lekë	kualifikuar
6.	“Malfina Visoka” P.F	5,207,700 lekë	kualifikuar
7.	“GET KLIN” SHPK	5,350,000 lekë	kualifikuar
8.	“ALBSOLUTION” SHPK	5,622,882 lekë	skualifikuar
9.	“ATLANTIK 3” SHPK	6,406,500 lekë	kualifikuar
10.	“Enea Masllavica” P.F	6,606,000 lekë	skualifikuar

II.3. Në datë 25.05.2023 autoriteti kontraktor ka kryer publikimin e Njoftimit të Fituesit në sistemin e prokurimit elektronik (SPE).

II.4. Referuar materialeve të fashikullit të shqyrtimit administrativ rezulton, se në datën 05.06.2023 nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është administruar ankimi elektronik me nr. A/2023/3158 dhe me nr. 1285 prot., datë 05.06.2023 e operatorit ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik dhe njëkohësisht paraqitur pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar vendimin e KVO-së mbi skualifikimin e ofertës së tij në procedurën e prokurimit objekt-ankimi.

II.5. Bazuar në nenin 112 pika 3 të ligjit 162/2020 “Për prokurimin Publik” Komisioni i Prokurimit Publik ka publikuar në bazën e të dhënave të tij, të dhëna për: a) ankimuesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës) si dhe me anë të formularit të publikimit nr. 1285/2 prot., datë 06.06.2023, janë publikuar arsyet e skualifikimit për të cilat operatori ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK ngre pretendime.

II.6. Me shkresën nr. 816/2., datë 12.06.2023 protokolluar me tonën me nr. 1285/3 prot., datë 15.06.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar Komisionin e Prokurimit Publik dhe operatorin ekonomik ankimues se autoritetit kontraktor i ka lindur nevoja për verifikime në lidhje me pretendimet e mgridura nga ana e operatorit ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK.

II.7. Me shkresën nr. 816/8 prot, datë 29.06.2023 protokolluar me tonën me nr. 1285/4 prot datë 03.07.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se autoriteti kontraktor me vendimin e datës 27.06.2023 ka pranuar plotësisht ankesën, si më poshtë vijon:

“[...]...KSHA konstaton se lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK nga komisioni i vlerësimit të oferve, APP shprehet se ky OE nuk ka qenë në kushtet e keqinformimit pasi Vepra penale, për të cilën është dënuar Z. Hair Shametaj, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë nuk përfshihet në kategorinë e veprave penale që parashikon neni 76/1 i LPP.

Sa më sipër, në zbatim të shkresës nr. 3818/4 prot., dt 16.06.2023 (protokolluar me tonën 260/9 prot., 21.06.2023) të Agjencisë së Prokurimit Publik,

Vendosi

- 1. Pranimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK për procedurën e prokurimit Loti I, me objekt “Blerje detergjent, dezinfektant dhe*

aromatizues”, me fond: 7,107,802 lekë pa TVSH, me nr. REF-58634-02-10-2023. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, dhe operatorët ekonomik të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.

2. *Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.[...]*”.

II.8. Nga verifikimet e kryera, rezulton, se nuk janë paraqitur pranë Komisionit të Prokurimit Publik argumente nga subjekte të interesuara lidhur me ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK, sipas parashikimeve të nenit 113 të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik”.

III Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëlidhur saj si dhe informacionit të autoritetit kontraktor

Arsyeton:

III.1. Lidhur me pretendimet operatorit ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK mbi kundërshtimin vendimit të KVO-së për skualifikimin e ofertës të tij në procedurën e prokurimit objekt-shqyrtimi, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se,

III.1.1. Me shkresën nr. 816/8 prot, datë 29.06.2023 protokolluar me tonën me nr. 1285/4 prot datë 03.07.2023, autoriteti kontraktor ka njoftuar Komisionin e Prokurimit Publik lidhur me trajtimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “EURO MEGA 2010” SHPK për procedurën e mësipërme të prokurimit, ku rezulton se autoriteti kontraktor me vendimin e datës 27.06.2023 ka pranuar plotësisht ankesën, si më poshtë vijon:

“[...]...KSHA konstaton se lidhur me arsyen e skualifikimit të operatorit ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK nga komisioni i vlerësimit të oferve, APP shprehet se ky OE nuk ka qenë në kushtet e keqinformimit pasi Vepra penale, për të cilën është dënuar Z. Hair Shametaj, në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të shoqërisë nuk përfshihet në kategorinë e veprave penale që parashikon neni 76/1 i LPP.

Sa më sipër, në zbatim të shkresës nr. 3818/4 prot., dt 16.06.2023 (protokolluar me tonën 260/9 prot., 21.06.2023) të Agjencisë së Prokurimit Publik,

Vendosi

1. *Pranimin e ankesës të paraqitur nga operatori ekonomik “Euro Mega 2010” SHPK për procedurën e prokurimit Loti I, me objekt “Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues”, me fond: 7,107,802 lekë pa TVSH, me nr. REF-58634-02-10-2023. Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë ankimuesin, dhe operatorët ekonomik të interesuar brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi.*

2. *Personi përgjegjës për prokurimin të njoftojë për vendimin e marrë Komisionin e Prokurimit Publik, brenda ditës së nesërme të punës nga marrja e këtij vendimi, duke e shoqëruar me shpjegimet dhe dokumentacionin përkatës.[...]*”.

II.1.2. Neni 30 i LPP-së parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesat e paraqitura para tij kur në mbledhje janë të pranishëm të paktën 3 nga 5 anëtarët e tij, një prej të cilëve kryetari ose nënkryetari. Në përfundim të shqyrtimit të ankesave, Komisioni vendos me shumicë votash. Vendimi deklarativ i dhënë sipas parashikimeve të nenit 115, pikat 2 dhe 3, të këtij ligji, jepet nga 3 anëtarë për procedurat e prokurimit nën kufirin e ulët monetar dhe nga 5 anëtarët për procedurat e tjera.*

III.1.3. Neni 115 pika 1 dhe 3 e ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” i cili parashikon shprehimisht se: *Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton ankesën e paraqitur, si dhe vendimin e autoritetit ose entit kontraktor, së bashku me dokumentet dhe shpjegimet shoqëruese, që mbështesin këtë vendim si më poshtë:*

a) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin pjesërisht të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik vazhdon shqyrtimin:

i. për pjesën e ankesës/pretendimeve që nuk janë pranuar;

ii. e ankesës/ankesave për pjesën që është pranuar, nëse ka ankesa nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre për këtë pjesë në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

b) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur pranimin e plotë të ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik do të vijojë shqyrtimin e ankesës, nëse ka ankesë nga operatorët ekonomikë të interesuar, të cilët kanë paraqitur argumentet e tyre në lidhje me ankesën në përputhje me nenin 113 të këtij ligji;

c) në rastet kur autoriteti ose enti kontraktor ka vendosur mos pranimin e ankesës.

3. Në rastin kur autoriteti ose enti kontraktor pranon plotësisht ankesën, Komisioni i Prokurimit Publik:

a) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga marrja e vendimit të dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor për këtë ankesë, nëse operatorët ekonomikë të interesuar nuk kanë paraqitur argumentet e tyre sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji;

b) nxjerr një vendim deklarativ për mbylljen e çështjes brenda 3 ditëve nga përfundimi i afatit kohor të përcaktuar në pikën 5 të nenit 114 të këtij ligji, nëse operatorët ekonomikë të interesuar, që kanë paraqitur argumentet sipas pikës 1 të nenit 113 të këtij ligji, nuk kanë ankimuar vendimin e dhënë nga autoriteti ose enti kontraktor.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30 pika 1, 115 pika 1 dhe 3 si dhe neni 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023 “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë komisionit të prokurimit publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, Neni 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendosi

1. Të mbyllë çështjen për ankesën e paraqitur nga “EURO MEGA 2010” SHPK në procedurën e prokurimit “Procedurë e Hapur – “Marrëveshje Kuadër – me disa operatorë ekonomikë – me afat 24 muaj” me Nr. REF-58631-02-10-2023, me objekt: Loti 1, “Blerje detergjent, dezinfektant dhe aromatizues” me fond limit **7,107,802** (shtatë milion e njëqind e shtatë mijë e tetëqind e dy) lekë (pa TVSH) **61,206** (gjashtëdhjetë e në mijë e dyqind e gjashtë) Euro pa TVSH. Kursi i këmbimit sipas Bankës së Shqipërisë datë 10.02.2023 është 116.13 lekë), parashikuar për tu zhvilluar në datën 15.03.2023 nga autoriteti kontraktor, Agjencia Shtetërore e Prokurimeve të Përqendruara
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës, që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga “EURO MEGA 2010” SHPK.
4. Kopje e këtij vendimi ti dërgohet Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nënkryetar
Fiorent Zguro

Anëtar
Kreshnik Ternova

Kryetar
Jonaid Myzyri

